



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Misioni në Shkup



## THIRRJE PËR PJESËMARRJE

### SHKOLLA VERORE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË DREJTËS PENALE

Ohër, 27 qershor- 03 Korrik, 2017

Universiteti "Goce Dellçev"- Shtip, Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti "Sh. Kiril dhe Metodij" në Shkup, përkrahur nga Misioni i OSBE-së në Shkup, shpallin thirrje për pjesëmarrje në **Shkollën verore për të drejtat e njeriut dhe të drejtës penale.**

**Synimi kryesor** i shkollës është që të rrisë njohuritë e studentëve në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtës penale, si dhe edukimin i tyre për tu ballafaquar me sfidat në këto lëmi si praktikues të ardhshëm ligjor. Shkolla gjithashtu ka për qëllim për të rritur ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve rreth shfaqjes dhe efektet e diskriminimit, gjuhën e urrejtjes dhe krimin të urrejtjes, dhe përfitimi për shoqërinë nga diversiteti etnik, gjuhësor dhe fetar.

**Qëllime** të shkollës verore:

- Përmirësimi i njohurive në fushën e të drejtave të njeriut, institucioneve efektive, efikasitet në sjelljen e vendimeve politike, e drejta penale dhe modelet e qeverisjes së mirë dhe marrëdhëniet ndëretnike;
- Përmirësimi i aftësive për identifikimin efektiv të sfidave kryesore në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtës penale duke propozuar modele për të tejkaluar ato sfida;
- Rritja e ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimi i studentëve mbi çështjet që lidhen me anti-diskriminimin, zvogëlimin e gjuhës së urrejtjes, fenomeni i krimin të urrejtjes dhe respektimi i diversitetit etnik, gjuhësor dhe fetar;
- Zhvillimi i aftësive për mendim kritik në procesin e mësimin të lëndëve në fushën e shkencës juridiko- politike dhe sociologjisë;
- Zhvillim i rrjetit ndërmjet studentëve nga fakultetet juridike të ndryshme, si potencial për aktivitetet e ardhshme të iniciuara nga ana e tyre në të cilën ata mund të paraqiten si bartës të tyre; dhe
- Akumulimi dhe transferimi të EKTS kredive mes universiteteve.

**Grupi i interesit-** Studentët e ciklit të parë të studimeve të rregullta nga fakultetet juridike shtetërore ose private në vend. Gjithsej do të zgjidhen 50 studentë prej të cilëve 14 studentë nga tre fakultetet juridike partnere, Universiteti "Goce Dellçev" - Shtip, Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti "Sh. Kiril dhe Metodij" në Shkup, dhe 8 studentë nga fakultetet e tjera juridike në kuadër të universiteteve shtetërore dhe private.

**Koha dhe vendi-** Shkolla verore do të mbahet ne periudhën 27 qershor- 03 korrik 2017, më një kohëzgjatje prej 7 ditësh, në hotelin Klimetica, Ohër.

**Gjuhët e punës** - Në gjuhën maqedonase dhe shqipe, me njohuri të nivelit themelor të gjuhës angleze. Përkthimi simultan do të jetë i siguruar gjatë ligjëratave.

**Temat** - Shkolla verore do të merret me tema që lidhen me të drejtat e njeriut ndër të tjera dhe mbrojtja nga diskriminimi, gjuhës së urrejtjes dhe krimet e urrejtjes, të drejtat e grave, dhe personave me aftësi të kufizuara, e drejta për punë si dhe temat që lidhen me të drejtën penale materiale dhe procedurale dhe temat që lidhen me multikulturalizmin. Më saktësisht, shkolla

verore do të jetë e ndarë në dy seksione të veçanta, i *pari* që ka të bëjë me të drejtat e njeriut dhe i *dyti* që ka të bëjë me të drejtën penale.

### **Transferimi i EKTS dhe Shtojca e diplomës**

Duke pasur parasysh se temat e shkollës verore janë plotësuese për disa nga lëndët e programeve të studimit në fakultetet juridike (E Drejta kushtetuese, Sistemi politik, Të Drejtat e njeriut, Sociologjia e drejtësisë, Shoqëria Civile, E Drejta Penale, E Drejta për procedurë civile, E Drejta për procedure penale, E Drejta publike ndërkombëtare, etj.), studentët do të kenë mundësi për të fituar një numër të caktuar të kredive, në pajtueshmëri me numrin e kredive në një lëndë të veçantë. Varësisht nga procedurat e brendshme të fakulteteve, për disa lëndë të veçanta do të pranohet numri i caktuar i kredive të fituara në shkollën verore. Pas përfundimit të ligjëratave në shkollën verore, studentët do të kenë një provim përfundimtar dhe do të marrin një certifikatë që mund të përdoret si një Shtojcë e Diplomës. Certifikatën do ta lëshojnë tre universitetet partnere gjegjësisht Universiteti "Goce Dellçev" – Shtip, Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti "Sh. Kiril dhe Metodij" në Shkup. Certifikata do të përmban përshkrimin e temave të përpunuara në shkollën verore dhe suksesin e arritur nga provimi.

**Mënyra e aplikimit dhe zgjedhja e pjesëmarrësve**- Të gjithë studentët e interesuar mund të aplikojnë duke plotësuar **formën për pjesëmarrje e cila është në dispozicion në linkun e mëposhtëm:** <https://goo.gl/forms/B1RiFLqVJuYIH0et1>, duke përfshirë edhe një letër motivimi (jo më shumë se një faqe). Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është **12 Maj 2017**. Duke mbushur formën për pjesëmarrje, studentet duhet të zgjedhin për cilin seksion aplikojnë, të drejtat e njeriut ose për të drejtën penale, duke shënuar me numra (1) ose (2) sipas preferencës [(seksioni më i dëshiruar duhet të shënohet më numër (1) dhe zgjedhja e dytë më numër (2)]. Organizatorët do të kryejnë një përzgjedhje të studentëve bazuar në **kriteret e mëposhtme:**

- Të jenë studentë të ciklit të parë të studimeve të rregullta në fakultetet juridike në vend, shtetërorë ose private
- Të janë në gjendje të marrin pjesë gjatë gjithë kohëzgjatjes së shkollës verore
- Të demonstrojnë një interes në temat si dhe motivim personal (nëpërmjet letrës së motivimit)
- Të parashirojnë dokumentacion të plotë (formën për pjesëmarrje të plotësuar në tërësi dhe letër motivimi)
- Të kenë njohuri themelore të gjuhës angleze

Bordi shqyrtues do të konsiderojë edhe **kriteret gjithëpërfshirëse** në vijim:

- Përfaqësimi i barabartë gjinor
- Diversitet etnik dhe kulturor
- Përfaqësimi gjeografik

*Vërejtje: Në procesin i përzgjedhjes mund të konsiderohet edhe sukcesi mesatar i studentit.*

**Shpenzime:** Shpenzimet e transportit, akomodimit dhe ushqimi për pjesëmarrësit dhe shpenzimet për materialet e punës do të mbulojnë nga organizatorët e shkollës verore.

**Personi për kontakt:** Deniza Bundalevska, e mail: [Deniza.Bundalevska@osce.org](mailto:Deniza.Bundalevska@osce.org)